



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Prishtina, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 01

Datë: 16. 01. 2017, ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Binak Vishaj, Bajram Ljatifi, Ercan Spat dhe Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP). Përkthyes: Vera Dula

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të KQZ-së nr.33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43 dhe 44/2016*

2. Raport i Këshillave të KQZ-së;

- **Këshilli për i Operacioneve Zgjedhore;**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i Historikut të zgjedhjeve 2000-2014*
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-projektit Dita Globale e Zgjedhjeve*
- **Këshilli për Çështje Ligjore;**
 - *Shqyrtimi i kërkesave për zëvendësimet e anëtarëve të Kuvendeve Komunale në Komunitet: Suharekë, Mitrovicë dhe Deçan.*

3. Njoftim për Përgatitjet e Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2017

4. Të ndryshme

1. Hyrje

Mbledhja, është kryesuar nga kryetarja, znj. Valdete Daka.

Valdete Daka: Përshëndetje në këtë vit të ri. Ju dëshiroj suksese. A ka dikush me shtuar për këtë rend dite?

Bajram Ljafiti: Kam diçka lidhur me KQZ-në, por në fund të mbledhjes...!

Valdete Daka: Kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës me vota unanime.

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbaleve e mbledhjeve të KQZ-së, nr. 33, 34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45/2016.

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për i Operacioneve Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Historikut të zgjedhjeve 2000-2014

Adnan Rrustemi: KOZ-i në mbledhjen e fundit, ka shqyrtuar dy pika të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Historikut të zgjedhjeve 2000-2014. Bëhet fjalë për një publikim që përmbledhë të gjitha proceset zgjedhore në Kosovë, nga vitit 2000-2014 duke ofruar të dhëna statistikore dhe krahasuese etj. Duhet ta themi se ky material, është ideuar dhe përgatitur nga OSBE, dhe është analizuar dhe shqyrtuar edhe në Sekretariat. KOZ-i, po ashtu, e ka shqyrtuar dhe ne mendojmë se ky material është i rëndësishëm prandaj, rekomandojmë për aprovim.

Betim Gjoshi: Edhe në këshill kam shprehur këto qëndrime: të gjithëve atyre që u interesojnë zgjedhjet, në këtë dokument mund të gjejnë të dhëna. Mendoj se duhet shënohet në botim, një falënderim për OSBE-në. Në anën tjetër, titulli është ndryshuar por, atë ditë nuk kemi biseduar. Ky titull nuk përkon sepse ky dokument, nuk është analizë! Pra, titull tjetër duhet përndryshe, e përkrahu dhe këtu, s'kam dilemë. Teksti, është i nevojshëm...

Pra, tha z. Gjoshi, ne duhet të botojmë edhe shumë tekste tjera që lidhen me përgatitjen dhe rolin e zgjedhjeve...

Bajram Ljafiti: Nuk kam ndonjë propozim të veçantë në këtë dokument historik për zgjedhjet, veçse mendoj se duhet të përmendet ligji për zgjedhjet, rregullativa...Por, të përmendet edhe formimi i KQZ-së sepse, kemi biseduar vitin e kaluar për 15 vjetorin e themelimit - veprimit, edhe pse nuk e kemi shënuar si jubile...Pra, mendoj që data ka qenë 10 prill 2000. Por, të përmendet edhe fakti se, zgjedhjet janë udhëhequr nga OSBE, si shtylla e tretë e administrimit ndërkombëtar në Kosovë.

Eshref Vishi: Në KOZ, ne e kemi pasur këtë material dhe kemi dhënë disa vërejtje në mënyrë që administrata të jetë e fokusuar në të sa i përket përmbajtjes së tekstit...Kemi kërkuar ndërhyrje dhe lekturim, besoj që këto administrata i ka përfillë rekomandimet e këshillit...

U tha se, është material që është përgatitur nga OSBE. Mirëpo, unë mendoj se prej këtij momenti të miratimit, ky material të kalojë në autorësinë e KQZ-së, dhe mbi këtë bazë unë kisha kërkuar me ditë se çfarë pune është bërë, përfilljen e autorizimit të KOZ-it...

Adnan Rrustemi: Është një material që e vlerësoj, dhe kjo e hap një proces për të cilin edhe kemi biseduar: nxjerrja e publikimeve dhe e materialeve që duhet ti hulumtojmë dhe ti botojmë në fushat e procesit zgjedhor...Shpresoj që ky material, ta shënojë fillimin e një procesi...

Këtu, jam për ta definuar titullin e këtij materiali në mënyrë që pastaj, të mos merremi më me të dhe, unë propozoj që titulli të jetë “Zgjedhjet në Kosovë: 2000 – 2014”...

Betim Gjoshi: Ka njerëz këtu që kanë përvojë në këtë drejtim, pra në aspektin përgatitjes dhe botimit...Le të merret edhe ISBN –ja...sepse, ky material është edhe referues...

Binak Vishaj: Se është material i nevojshëm dhe kemi pas nevojë për një material të këtillë, është e vërtetë dhe prandaj, ka njerëz që merren me studim, e që kanë pasur nevojë që të kenë material bazik...Ne, tha z. Vishaj, të vendosim këtu për titullin dhe të mos merremi më me të...Pastaj, OSBE ka premtuar se do ti heqë shpenzimet e botimit: sa kopje...?

Valdete Daka: Të vendosim për titullin, më duket që “Zgjedhjet në Kosovë: 2000 – 2014” është adekuat, i përshtatshëm... A po pajtohemi për këtë titull...?

Adnan Rrustemi: Të bëhet edhe një dizajn i mirë, i ndërthurur...një kopertinë mozaik...!

(Anëtarët e KQZ-së, diskutuan edhe rreth përmbajtjes, madje edhe rreth konceptit, strukturës, redaktimit etj.)

Enis Halimi: Sigurisht, ne do t'i përfshijmë këto që u thanë këtu sepse, natyrshëm s'ka kuptim që ky botim të mos bëhet në kornizat e duhura...Mirëpo, cip-katalogimin nuk e di se, a mund ta marrim...! Kurse, OSBE do të ndihmojë botimin e këtij materiali në 200 kopje: 100 në gjuhën shqipe, 40 në gjuhën angleze, dhe 40 në gjuhën serbe.

Valdete Daka: Po e votojmë këtë material...Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan botimin e materialit për zgjedhjet.

Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-projektit “Dita Globale e Zgjedhjeve”

Adnan Rrustemi: E kemi trajtuar në KOZ, edhe draft projektin Dita Globale e Zgjedhjeve...Jemi në dijeni për këtë ditë, sepse tashmë KQZ ka filluar ta shënoj këtë ditë në mënyrë tradicionale me disa aktivitete simbolike. Për këtë vit, Sekretariati ka propozuar disa aktivitete: është menduar që përmes zyrtarëve komunal, të shpërndahet nëpër shkollat e mesme një fletëpalosje për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje. Në vijim, besoj që Sekretariati do ta hartojë si material, dhe ne do ta kemi sa për dijeni...si dhe, publikimin e dokumentit që sapo e miratuar...

Është diskutuar që ky material, të prezantohet edhe në manifestimin e ditës së shënimit, dhe bashkë me librin, të bëhet edhe një fletëpalosje që do të ketë karakterin informativ rreth KQZ-së...Rekomandojmë KQZ-së për miratim...

Betim Gjoshi: Dizajni nuk është në rregull, nuk është në nivel...Ftesa nuk paraqet seriozitet. Agjenda, duhet të jetë e saktë, dhe që sot t'i ndajmë detyrat: përgatitja e fletushkës, protokollit, aspekti teknik etj. Le ta caktojmë tani një grup, ose krye shefi ti caktojë...

Pra, tha z. Gjoshi, ta organizojmë takimin në mënyrë institucionale, si duhet...

Enis Halimi: Prej sot, meqë po e saktësojmë edhe formatin e manifestimit, do fillojmë menjëherë me përgatitjet. Nuk jemi vonë, dhe besojmë se do t'ia arrijmë...pra, kemi kohë të mjaftueshme...!

Ercan Spat: Kemi dhënë vërejtjet në KOZ, disa prej tyre edhe janë përmirësuar...Mirëpo, patëm vërejtje rreth listës së të ftuarve...Kërkoj nga krye shefi që të kontrollohet lista e të ftuarve...

Binak Vishaj: Nuk na mungon përvoja, sepse edhe në të kaluarën e kemi shënuar këtë ditë...Prandaj, besoj që do t'ia arrijmë...

Betim Gjoshi: Nëse vendosim realisht, ftesa duhet të ketë përmbajtjen e agjendës, ose të dërgohet bashkë me agjendën...Pra, ftesa ti ketë informacionet e nevojshme...

Valdete Daka: OSBE është e gatshme të na ndihmojë dhe se ajo, do t'i mbulojë shpenzimet për deri në 100 persona, kurse pjesën tjetër e mbulojmë ne...

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan draft-projektin "Dita Globale e Zgjedhjeve"

3.Këshilli për Çështje Ligjore

*Shqyrtimi i kërkesave për zëvendësimet e anëtarëve të Kuvendeve Komunale në Komunitet:
Suharekë, Mitrovicë dhe Deçan.*

Sami Hamiti: Sot, e kemi zhvilluar mbledhjen e këshillit, dhe i kemi trajtuar kërkesat e kryesuesve të katër komunave për zëvendësime të anëtarëve të kuvendeve komunale...Dhe janë: një zëvendësim në Suharekë, dy në Mitrovicë, një në Deçan dhe një në Prishtinë. Në

mbledhje, kemi konstatuar se të gjitha kërkesat i plotësojnë kushtet formalo – juridike dhe ligjore.

Valdete Daka: Po shkojmë me radhë:

Kush është për që Fatime Tishukaj, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Deçan, nga subjekti politik AAK – LDD, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal, Suzana Mustafajn.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë zëvendësim.

Kush është për që Sali Bytyqi, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Suharekë, nga subjekti politik AAK – LDD, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal, Besim Kuqi.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë zëvendësim.

Kush është për që Hysen Muzliukaj, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal, Faruk Mujka.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë zëvendësim.

Kush është për që Fisnik Pllana, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga subjekti politik “Të pavarurit e Mitrovicës”, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal, Ahmet Demaj.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë zëvendësim.

Kush është për që Shefqet Sylejmani, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal, Sokol Krasniqi.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë zëvendësim.

4.Njoftim për Përgatitjet e Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2017

Valdete Daka: E kemi edhe një pikë, por material nuk kemi...!

Enis Halimi: Është vetëm njoftim, prandaj Sekretariati ashtu si edhe në vitin e kaluar ka filluar përgatitjen për paraqitjen e aktiviteteve që do të realizohen në vitin 2017. Pra, e kemi vit zgjedhor, dhe jemi bazuar në dokumentet tona strategjike. Secila njësi, i ka nxjerrë aktivitetet që synon ti përmbushë në përputhje me strategjinë e planit, dhe rrethanat e tjera...

Po ashtu, tha z. Halimi, kemi edhe aktivitete që janë të rëndomta, ligjore...Aktivitetet janë të gatshme, dhe na mbetet që ne të bëjmë një strukturim dhe fuzionim në një dokument...pra në planin strategjik...Aktivitetet janë gati, dhe është çështje e vendimmarrjes se si do të procedohet më tutje....

Sami Hamiti: E para, po kalon muaji janar e plani i punës nuk është bërë, jo vetëm për veprime strategjike por as për aktivitete dhe plane të tjera që ndërlidhen me planin e punës që as ne, se kemi bërë e që këto ndërlidhen mes vete...E dyta, cilat aktivitete do t'i bësh: ku i ke aktivitetet, a e ki planin e prokurimit, kur shkojnë...?

Nëse nuk marrë një draft – plan përpara, unë s’do të jem pjesë e shqyrtimit, nuk do të vi...!

(P.s. Nuk ka stenogram – incizim të mbledhjes në vazhdim të saj...!)

5. Të ndryshme